



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
SHOQËRIA RAJONALE  
UJËSJELLËS KANALIZIME LEZHË SH.A

*Lezhë ,me date \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2024*

## **PROCESVERBAL**

### **Tipi i kontratës - Shërbime**

## **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

### **OBJEKTI I PROCEDURËS:**

Shërbim furnizim / Vendosje pjesë këmbimi për automjetet e Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanaliime Lezhë Sh.a.

**Numri i referencës së procedurës /Lotit:** REF-27979-11-4-2024

### **KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

50110000-9 Shërbime për riparimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve dhe pajisjeve të lidhura

42913300-2 Filtra vaji

42913400-3 Filtra nafte

42913500-4 Filtra ajri

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 2 347 333 (dy milion e treqind e dyzet e shatë mijë e treqind e tridhjetë e tre) lek pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Lezhë Sh.a** ka hartuar

Adresa :Lagjja "Nene Tereza", Rruga Bajram Curri, Ndertese 2-Kateshe ne zonen kadastrale nr.8632, numri i pasurise 1/130, Lezhë.

procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;*

*b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 10*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

---

---

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare ( 2021,2022,2023) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 20 %** e vlerës së përlllogaritur të kontratës.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 20%** e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet është në përpjesëtim dhe e lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Ajo i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses

të kontratës, bazuar kjo në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. neni 43, pika 6.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998 ”Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM –së Nr.992, datë 29.12.2014 ”Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumentave të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 ”Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

---

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar në sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose / dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) Për përvojën e mëparshme të realizuar në sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

## **Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

### **Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:**

Duke qënë se procedura e përzgjedhur është procedurë “E Hapur e Thjeshtuar” dhe bazuar tek e VKM Nr.285 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, dt 19.05.2021, i ndryshuar; neni 55, pika 4, ku shprehimisht thuhet: “*Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm*”. Për këtë arsye u vendos që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se **20%** të vlerës së fondit limit.

---

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë liçencë nga QKB për prodhimin ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore me Kod VII.3.B.1 “*Deshmi te aftesise profesionale*”.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 40, pika 5/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

---

**2.3.3** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt prokurimi, duhet të disponojë personelin kryesor si më poshtë:

- |                           |                     |
|---------------------------|---------------------|
| - Drejtues teknik         | 1 (një)             |
| - Ing. Mekanik/mekatronik | 1 (një)             |
| - Motorrist               | 1 (një)             |
| - Mekanikë                | Jo më pak se 2 (dy) |

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- CV;
- Deshmi aftesi profesionale KODI VII-3-B-3-A,B
- Diplomë ose çertifikatë dhe
- Kontratë të rregullt pune

Kriteri i mësipërm konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e **formularit përmbledhës të vetëdeklarimit (shtojca 10)**

*Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor do t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentat provuese për vetëdeklarimin në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, I ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

**2.3.4** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimit objekt prokurimi duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 7 ( shtatë) persona**, vertetuar me ;

- a) Vërtetim të leshuar nga Administrata Tatimore për muajin e fundit (korrik 2023);
- b) Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit (shtator 2024), të konfirmuara nga organet përkatëse.

*Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit ( shtojca 10).*

**Në rastin e shpalljes fitues të Operatorit ekonomik, para lidhjes së kontratës, Autoriteti Kontraktor do të kërkojë nga OE fitues të paraqesë për fuqinë punëtore dokumentacionin ( origjinal ose kopje të noterizuar) të sipërcituar.**

**Argumentimi:**

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur sipas shërbimit konkret që kërkohet dhe punonjësve specialist që nevojiten dhe që janë kërkuar për këtë shërbim. Gjykohet se **7 (shtatë) punonjës** janë të mjaftueshëm për realizimin me sukses të shërbimit, objekt kontrate.

**2.3.5** Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me çertifikatën ISO 9001-2015 dhe / ose SSH EN ISO 9001:2015 standarti Shqiptar ekuivalent i normave europiane, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit, të vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës së prokurimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe në nenin 44, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Çertifikata e mesiperme kërkohet nga autoriteti kontraktor SHRUK Lezhë Sh.a per te vertetuar se malli objekt prokurimi i

ploteson kerkesat e cilesise nepermjet çertifikatave te leshuara nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organzima nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise.

**2.3.6** Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me çertifikaten ISO 14001-2015 dhe/ ose SSH EN ISO 14001-2015 standarti shqiptar ekuivalent i normave europiane për menaxhim mjedisi, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe në nenin 44, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Çertifikata e mesiperme kerkohet nga autoriteti kontraktor SHRUK Lezhë Sh.a per te vertetuar se malli objekt prokurimi i ploteson kerkesat e cilesise nepermjet çertifikatave te leshuara nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organzima nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise.

**2.3.7** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Makineri/Pajisje	Sasia	Gjendja
1	Mjete ngritëse dhe transportuese mbi 3 ton si: - karrotrec; -rimorkiator; -transportier.	Copë 1 Copë 1 Copë 1	Pronësi ose me qera

**Në çdo rast, përpara se të japë kontratën Autoriteti Kontraktor do t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetdeklarimet në formularin përmbledhës të vetdeklarimit.**

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës është bërë përlllogaritja në bazë të zërave të preventivit.

**2.3.8** Të ketë servis të rregullt në pronësi apo me qera me dhe jo me pak se 5 ura ngritëse dhe 1 grope për mjetet e rënda ( të paraqese certifikate pronësie apo kontrate qeraje për servisin (origjinale ose te noterizuara) si dhe foto të urave ngritese dhe të gropave për mjetet e rënda.

**Argumentimi:** Kërkesa e mesiperme eshte percaktuar bazuar ne nenin 77 te ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “ Per prokurimin Publik” I ndryshuar ne nenin 41, pika 4, shkronja ç te VKM Nr. 285, datë19.05.2021 “ Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

**2.3.9** OE Ofertues duhet:

1. Të paraqesë një Vetëdeklarim, ku merr përsipër transportin e mjeteve deri në servisin e vet.
2. Të paraqesë një Vetëdeklarim, ku merr përsipër se garancia e shërbimit të furnizim/ vendosje do të jetë 12 ( dymbëdhjetë) muaj.

**Argumentimi:** Bazuar në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 41, pika 8: *“Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të vecanta, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*

Kriteret e mësipërme janë vendosur në varësi të natyrës së shërbimit që kërkohet, të cilat gjykohet se janë të nevojshme dhe të rëndësishme për mbarëvajtjen me sukses të kontratës.

**Argumentim:** Specifikimet teknike per shërbimet objekt prokurimi jane hartuar ne perputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36 te LPP, si dhe nenin 41, pika 1, te VKM Nr. 285, date 19.05.2021 “ Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Specifikimet teknike jane hartuar mbi gjendjen teknike aktuale te automjetit si dhe kërkesa per shërbimet e mirembajtjes te automjetit te cilat planifikohen mbi bazen e normativave teknike sipas kilometrave te pershkuar, ne zbatim te standarteve dhe kërkesave te Kodit Rrugor te Republikës se Shqipërisë, miratuar me Ligjin Nr. 8378, date 22.07.1998, i ndrushuar, Regullores se zbatimit te Kodit Rrugor ne Republikën e Shqipërisë, miratuar me vendimin e Keshillit te Ministrave Nr. 153, date 07.04.2000, i ndyshuar; Direktives 2009/40EC, date 06.05.2009 “ Mbi inspektimin teknik te mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove.

**Kriteret e kualifikimit janë vendosur në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës me qëllim që të vërtetohet se operatorët ekonomikë që do të marrin pjesë në këtë procedurë prokurimi kanë kapacitetet ligjore dhe kualifikimet e nevojshme teknike e profesionale si edhe pervojën e duhur për përmbushjen me sukses të kontratës, objekt i këtij prokurimi, e cila ka një specifikë të vecantë.**

Dokumentacioni pasi u firmos nga të tre anëtarët e Njesisë së Prokurimit, pasi u përpilua edhe Formulari Përmbledhës i Njoftimit të Kontratës, do i paraqitet Titullarit të Autoritetit Kontraktor për tu nënshkruar dhe u ra dakort që të hidhen në Sistemin Elektronik të Prokurimit për publikim dhe shpallje nga APP.

### **NJËSIA E PROKURIMIT**

**Jozefina Zefi**

**Bora Kolbuçaj**

**Flora Gjini**

---

---

---